

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 20 TETOR 2022

Ky debat është absolutisht një nga debatet më të rëndësishme që ne kemi zhvilluar në Kuvendin e Shqipërisë, një debat i vonuar, por shumë i domosdoshëm, për disa arsye të mëdha.

Përballë nesh kemi një qeverisje, e cila krizën përpiqet ta përballojë si gjithmonë me propagandë. Çfarë keni dëgjuar ju? Ju keni dëgjuar që nuk është koha për debat, nuk është koha për të folur se është luftë dhe, meqë është luftë, nuk duhet të flasim, por vetëm të grabisim, të rrëmbejmë dhe të ecim përpara! Njëherazi na thonë që për shkak të luftës kemi probleme me çmimet e të tjera. Sa herë që u themi që ju nuk jeni në vijën e parë të luftës, ata janë në vijën e parë, ukrainasit, dhe i kanë çmimet disa herë më poshtë se ne, dhe u bëjmë pyetjen: “Si ta zgjidhim ne këtë?”, përgjigje nuk ka, sepse nuk ka se çfarë përgjigjeje të ketë.

Sigurisht, kjo është qesharake. Mua më kujtohen ato historitë e Partisë së Punës që kur ishte koha e tallonit, u merrte çmime për bukën dhe u çante dërrasat njerëzve me propagandë nga mëngjesi deri në darkë, duke ua neveritur sa nuk kishte ku të vente më. Çfarë dëgjojmë sot? Duke pasur një qëndrim, një front të vërtetë në kuptimin më të mirë të fjalës, kundër një trajtimi të diferencuar, që ishte thjesht dhe vetëm korruptiv dhe nuk ishte asnjë kuptim tjetër lidhur me fashën 800 kilovat, teksa kërkuam pafundësisht që kjo të mos vendosej, këta e bindën gjithë dynjanë, kanë mbajtur fjalime kilometrike se pse duhet vënë, duke thënë: “Nuk ka asnjë rëndësi, janë vetëm 3 apo 4% e popullsisë, janë pak dhe nuk ka asnjë gjë, do ta bëjmë se s’bën, nuk kthehem prapa, nuk ju dëgjojmë fare ju” e të tjera nga këto dëngla, ndërsa tani hajdeni të bëhemi seriozë! Tani na thonë: jeni ju të mërëzitur se nuk u vu fasha, sepse nëse do të vendosej fasha, do të bënit mitingje. Më falni, idiotësia ka kuptim, por jo kaq, mos i pandehni njerëzit idiotë!

E bënin këtë propagandë ata para viteve ’90-të dhe më pas i morën zvarrë, edhe monumentet ua hodhën, duke u treguar se nuk e kishin ngrënë këtë propagandë. Çfarë ju thamë? O shtet, o të marrë, nuk i vini dhe i hiqni ju! Keni vënë një institucion që e zgjidhni këtu në Kuvend, por duhet ta hiqni. U kujtuan pas 2 javësh, në kohën kur Rregullorja e ka shumë të qartë që duheshin 7 ditë që të bëhej kërkesa për ta rishikuar. Dhe çfarë prove dhanë? Dhanë provën që një institucion të pavarur e kanë shndërruar në një rreckë pa asnjë lloj autoriteti, e shpëlanë si institucion të pavarur dhe dhanë të kuptohej se kjo këtu është një zyrë që i vë njerëzit, ndërsa ne nuk i respektojmë, po të duam vjen i pari ynë dhe thotë: sot e vë dhe

nesër e heq. Ky nuk është shtet, por është një turp haxhiqamilit. Nëse ju jeni ortakë me të, ne nuk jemi për këtë shtet, por jemi për një shtet serioz, i cili nuk e vë fashën dhe jo për një shtet karagjoz që thotë: ra 2 ditë shi dhe u mbush hidrocentrali dhe çdo gjë e rregullua, ndërkohë që njerëzit kanë 7 apo 8 ditë që kanë filluar të kursejnë. Na i kurseni këto turpe, kursejuani shqiptarëve!

Gjithashtu, na referoni Brukselin, ka direktiva në Bruksel, bëhet në Bruksel, bëhet në Europë. Shumë mirë bëni që i referoheni Brukselit, ju marrsha të keqen që i referoheni Brukselit ju, por unë pres t'i referoheni edhe kur ju thotë Brukseli jo me atë portin e Durrësit, jo me atë amnistinë fiskale apo që ne po ndërhyjmë tek taksat dhe tatimet e vendeve tona vetëm për t'i ndihmuar qytetarët. Brukseli thotë se po bën disa paketa të mëdha të ndihmës shoqërore që t'i ndihmojë qytetarët. Më pas Brukseli thotë mos u merrni me ligjin e shpifjeve aq sa detyrohet dhe shkon edhe në Gjykatën Ndërkombëtare. Këto "brukselit" nuk ekzistojnë, nuk pyesim për Brukselin se nuk na tregon vendin, ndërsa kur vjen puna, më pas thoni na ka dhënë edhe një direktivë Brukseli! Mos u tallni me Brukselin dhe me askënd tjetër, talluni me veten tuaj po të doni, se nuk ju ndal njeri, por mos u përpiqni të na mbushni mendjen neve. Ky është Brukseli me të gjithë komponentët e tij, jo me ata komponentë që e lënë qytetarin në mes të 4 rrugëve, sepse nuk ju interesojnë ata kur është puna për ta ndihmuar qytetarin, nuk na duhet Brukseli, ndërsa për t'u justifikuar dhe për të rrëmbyer para, Brukseli na duhet.

Pikërisht në këtë moment, kur të gjithë mendojnë që duhet inkurajuar prodhimi i energjisë, të kemi sa më shumë energji lokale, vendase, patjetër gjithçka për energjinë, del Kryeministri, kryegjyqtari i Shqipërisë dhe thotë: "Do t'u vë tatim të jashtëzakonshëm atyre që prodhojnë energji elektrike". Bukur, do ta vësh tatimin e jashtëzakonshëm, në rregull, por vërua edhe atyre oligarkëve të naftës që i ke vënë në bord, që rrinë e ndajnë tavën bashkë. Nuk ka për ata që i bëjnë tenderat 100%? Madje, ti kujdesesh t'u japësh edhe para, se nuk u del llogaria mirë, ndërsa atyre që e prodhojnë energjinë u vë tatim të jashtëzakonshëm. Kush i ha këto? Po ata që i kontrollojnë, sepse të njëjtët oligarkë kontrollojnë edhe çmimet e ushqimeve, duke i rritur me 70 apo 80%, apo kjo nuk ka rëndësi? A ka ndonjë të pavërtetë nga këto që po ju them? I sfidoj të gjithë ata që thonë se nuk është e vërtetë asnjëra prej këtyre, sepse faktet janë të tyret. Pra, këtyre njerëzve u vendoset tatim i jashtëzakonshëm në një kohë që ky prodhim na duhet, sepse e kemi strategjik dhe po bëjmë hatanë e zezë, por nuk ka përgjigje. Çfarë do t'u themi, që kanë 10 vjet radhazi që merren me antikuariate?

Kanë 10 vjet që kanë detyrimin të qeverisin, por ndërkohë gjatë këtyre viteve kanë shpenzuar qindra milionë. Për çfarë i kanë shpenzuar? I kanë shpenzuar që të ulin humbjet teknike; nja 700 apo 800 milionë euro, largqoftë mos kanë vajtur te 1-miliardëshi, nuk e kanë ulur as 1%! Ku shkuan paratë? Ky quhet

keqmenaxhim, hajdutëri është fjala tamam që ta kuptojnë të gjithë njerëzit, pra për qindra milionë lekë nuk ulet fare.

Menaxhim i mrekullueshëm! Po, ia merrni edhe lekun e fundit qytetarit, e fusni edhe në burg. Ky është një fakt, por ka edhe raste të tjera tronditëse, sigurisht, sepse të fusësh një qytetar në burg për 50 apo 100 mijë lekë është një traumë e madhe. Po të merrnin ndonjë prej jush dhe ta fusnin për 100 mijë lekë në burg, do ta shihnit se çfarë do të bëhej. Çfarë ndodh me shtetin e famshëm? Janë me qindra miliona euro borxh për mospagesë energjie aq sa kanë falimentuar ujësjellës pa fund. Kush i qeveris? Këta i kanë. Kujt t'ia kërkojnë, opozitës? Këta janë nëpër zyra, këta firmosin, vjedhin dhe grabisin, ndërsa fajin e ka opozita. Çfarë faji ka opozita? Opozita ka fajin se nuk duhet të thotë të vërtetën. Opozita do ta thotë gjithmonë të vërtetën, sidomos kur hajdutëria është me prova, shkresa dhe fakte. Shyqyr Zotit këta nuk janë kujdesur për dokumentet dhe i kanë sheshit të gjitha, do t'jua themi të gjitha. Çfarë duhet të bëjmë, të vijmë këtu e t'u themi: aferim, shiko, ju vidhni, por është luftë e ne nuk flasim. Po, more po, kontrolli mbi çdo para publike nuk do të ketë ditë që nuk do të bëhet, nuk do të ketë drujtje për ta bërë këtë punë, kushdo që, kush dëshiron, mund ta bëjë këtë kontroll, sepse, nëse nuk do ta bënim, do të ishim fajtorë të mëdhenj para qytetarëve.

Në një moment shumë të madh (Perëndia na ka ndihmuar, sepse kemi origjinë gjeodiellore me bollëk, gëzohemi për këtë), çfarë kanë bërë këta për diversifikimin? Duhet t'u referohen objektiva të tyre jo të mijave, atyre që kanë shkruar e zeza në të bardhë, sepse këta nuk kanë turp, e shkruajnë të zezën në të bardhë dhe pastaj thonë: "Ani, nuk ka rëndësi pse i shkruam. Çfarë janë dokumentet dhe strategjitë?".

Ditën e prezantimit të strategjive ziejnë televizionet, janë gati 40 media *live*, që të shihet sa të bukura dhe të përgatitura janë, me një format elektronik të admirueshëm, por, kur i referojmë ne, thonë: "Lëre tani se nuk ka rëndësi". 38% duhej të ishin nga burimet e energjisë së diversifikuar. Sa është? Asgjë. Këta do të kontrollonin sistemin me matësit smart që të shihej sa ishin humbjet. Nga afro 1 milion as 7 apo 8 mijë nuk kanë vënë. Çfarë t'u themi ne, bravo, që batërdisni qindra milionë euro? Ky është fakt. Ndërkohë, asnjë gjë nuk ndodh, asnjë nuk ndihmoni, asnjë pengesë nuk hiqni në mënyrë që çdolloj burimi energjie të vihet në lëvizje në këtë vend, sepse i kemi të gjitha mundësitë për të mos ia pasur nevojën askujt për asgjë.

TAP-in e bënë të tjerët, ishte meritë e tyre dhe jo e këtyre, zero meritë kanë për atë punë. Po për të lidhur TAP-in me TEC-in e Vlorës për ta vënë në punë kush i pengoi? Ata vazhdojnë me historinë që TEC-i i Vlorës është bërë në vitin 2011, ndërkohë që ka filluar që në kohën e Fatos Nanos në vitin 2004, meqë e keni

mendjen e hutuar, investimi i parave, por kjo nuk ka rëndësi se koha e Fatos Nanos ka qenë koha e armiqve të tyre, ndërsa këta janë ringjallja dhe rivdekja.

Me fjalë të thjeshta situata është e tillë dhe për këtë ne kemi depozituar 2 nisma konkrete për të lehtësuar në mënyrë të veçantë energjinë e rinovueshme, diellore dhe të erës. Ju duhet të tregoni vullnet dhe t'i fusni në procedurë me shpejtësi të madhe, t'i miratojmë dhe të japim përgjigje konkrete, siç mund t'i jepet krizës, pa u marrë me dëngla dhe demagogji, sepse të gjitha këto bien mbi qytetarët. Ato qindra miliona që merren, i paguajnë qytetarët, sepse ju nuk paguani asnjë gramë nga kjo batërdi e madhe. Faleminderit!